



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 496 Prot.

Tiranë, më: 16.01. 2020

Vendimi 02

REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI :

Mos paisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: "PETRAX" sh.p.k.

Nr. NIPT-i: K12511610N

Adresa e selise: Zona Kadastrale Nr. 2007, pasuria Nr. 28/1, Bashkia Dropull, Jorgucat,
Rrethi Gjirokastrë

Personi përgjegjës: Jani Lleshi

Për të zhvilluar projektin "**Shfrytëzim i gurit gëlqeror pllakor zona minerare 953/1**"

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojça I, "Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: objekti 'Jorgucat', Gjirokastrë

(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti, ndodhet jashtë zonës së mbrojtur dhe nuk prek asnjë Monument Natyre.

2. Arsytet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

- Lidhur me këtë aplikim, Mungon Njoftimi Fitues për zhvillimin e aktivitetit nga institucioni përgjegjës (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), ose një Akt-Miratim i mëparshëm, që të tregojë nëse aktiviteti është ekzistues.
- Raporti VNM-së, është hartuar si VNM Paraprake, nuk janë mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtonte në raportin e thelluar të VNM-së, për sa i takon menaxhimit të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- Duke patur parasysh që shfrytëzimi është sipërfaqesor dhe ka një ndikim shumë të madh në mjedis, nuk janë zgjeruar problematikat që duhen trajtuar në Raportin e Thelluar të VNM, duke iu përmbajtur strukturës së hartimit të këtij raporti.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, nuk janë përshkruar masat konkrete i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.
- Informacioni i paraqitur nuk i përmbahet kushteve dhe kriterëve të "Planit të veprimit për veprimtaritë minerare ndërtimore", sipas Urdhërit të përbashkët Nr. 67, datë: 11.03.2018, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM


EDISON KONOMI

MINISTRI


BLENDI KLOSI



1. Anex 1. Harta dhe koordinat

HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIRIN DHE KOORDINATAT E LEJES MINERARE TE SHFRYTEZIMIT
Nr. 953, DATE 18.07.2006, OBJEKTI: "JERGUCAT", GJIROKASTER
SHKALLA 1:25 000

PLANSIETI - J-34-005-B-a

Koordinatat e lejes minerare
te shfrytezimit Nr. 953

Nr.	Y	X
1	44 37 475	44 21 885
2	44 37 600	44 21 950
3	44 37 700	44 21 750
4	44 37 575	44 21 700

Siperfaqja = 0.0298km²

Jergucati

Zarvati